



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për:	Mytaher Haskuka, Kryetar i Komunës së Prizrenit Sulltan Badalli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Goran Rakić Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së Trim Berisha, Zv. Sekretar Përgjithshëm i MPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 04.02.2021 VI-020-1171/5
Zyrtaret përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Leonora Bajrami, Zyrtare për monitorim të komunave	
Lloji i aktit:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Prizrenit <input type="checkbox"/> Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet, me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim i Kuvendit të Komunës Nr.001/011-17639 për anulimin e vendimit Nr.001/011-160724 të datës:11.11.2019 mbi hyrjen në koncesion të pronës komunale.

I miratuar më datë: 28.01.2021

I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 03.02.2021

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjisllacionit në fuqi. Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Mytaher Haskuka, gradonačelnik opštine Prizren Sulltan Badalli, predsedavajući Skupštine opštine Prizren	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MLS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Goran Račić, zamenik premijera i ministar MLS-a Trim Berisha, zamenik generalnog sekretara MLS-a.	
Od:	Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MLS	Dana, 04.02.2021 Br.020- 1171/5
Službenik-ca: za potvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština	
Službenik-ca: za izradu pravne procene:	Leonora Bajrami, službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta Skupštine opštine Prizren	
Vrsta akta:	Odluka	

Uvaženi gradonačelnice,
Uvaženi predsedavajući

U saglasnosti sa Uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 06/2020 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MLS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:


Odluka skupštine opštine br.001/011-17639 o ukidanju Odluke br.001/011-160724 od dana, 11.11.2019. godine, o stupanju na koncesiji (dopuštenje) opštinske imovine.
Usvojena dana, 28.01.2021.
Predložena na razmatranje u MLS-u dana, 3.02.2021.

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da opštinski akt iz proceduralnog aspekta u saglasnosti sa zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi.

Ministartstvo lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.




Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



001-011-17639 / 03.02.2021

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren - Prizren Belediyesi



Në bazë të nenit 12 paragrafit 2 shkronja d), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, lidhur me nenin 53 dhe 54 paragrafit 1 pika 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 27 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643, të datës 15 tetor 2008, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës dhe kërkesës së MPL-së nr.020-117/3 të datës 12.12.2019, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 28 janar 2021, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR ANULIMIN E VENDIMIT NR.001/011-160724 TË DATËS 11.11.2019 MBI HYRJEN NË
KONCESION TË PRONËS KOMUNALE

Neni 1

APROVOHET: propozimi i Kryetarit të Komunës, i cili ka për qëllim anulimin e Vendimit Nr.001/011-160724 i datës 11.11.2019 mbi hyrjen në koncesion pronës komunale.

Neni 2

Pas kërkesës së MPL-së nr.020-117/3 të datës 12.12.2019, për rishqyrtimin e Vendimit Nr.001/011-160724 të datës 11.11.2019, për shkak të ndryshimit të procedurave të parapara ligjore me hyrjen në fuqi të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe mos mundësisë së plotësimit të kërkesave të përcaktuara nga ana e MPL-së, Kuvendit të Komunës së Prizrenit e anulon Vendimin e lartcekur.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor dhe Drejtoria e Administratës-Spektori i Pronës

Neni 4

Ky Vendim, hyn në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 dhe 82 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb - faqen zyrtare të Komunës së Prizrenit.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr. 001/011- 17639
Më: 28 janar 2021
Prizren

